

# Buletini i Financave Publike - Mars 2014

nga Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje

*Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë sapo publikoi Statistikat fiskale për muajin Mars 2014. Në shërbim të analizës janë të disponueshme të dhënat kumulative për të ardhurat publike, shpenzimet qeveritare, investimet publike dhe deficitin buxhetor nga Janari 1998 deri në Mars 2014.*

Duke analizuar ecurinë e financave publike, *Arben Malaj*, Kryetar Bordi i IPPM shprehet:

“Treguesit e buxhetit për muajin Mars dhe 3-mujorin e parë 2014, të krahasuara edhe me trendet afatgjata tregojnë se duhet një fokus më i plotë në realizmin e të ardhurave tatimore sidomos në zërin akciza, ku vihet re një rënie prej 2 miliardësh nga plani, dhe një realizim pa vonesa e luhatje i investimeve të planifikuara me financim të brendshëm dhe të huaj.”

Krahasimet kryesore:

- **Të ardhurat publike** në muajin Mars 2014 shënuan vlerën 29.7 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë vihet re një rritje prej 14.39 % e të ardhurave shkaktuar kryesisht nga rritja e të ardhurave tatimore.
- **Shpenzimet totale** kanë shënuar një rritje me 9.64 % krahasuar me shpenzimet totale të muajit Mars 2013. Një ndër faktorët që ka ndikuar është rritja e investimeve publike me 2.68 miliardë lekë.
- **Investimet publike** gjatë muajit Mars ishin në vlerën 7.71 miliardë lekë ose rreth 53.52 % më lart në raport me investimet e realizuara në të njëjtin muaj një vit më parë. Kjo rritje është shoqëruar me rënien e financimit të brendshëm dhe rritjen e financimit të jashtëm në terma vjetorë.



secretary@ippm.al  
www.ippm.al

Rr. Ismail Qemali, P.27/1  
Tirane, Shqiperi

---

*për t'u bërë pjesë e listës  
prioritare ju lutem na  
shkruani në  
secretary@ippm.al*

---

Kryetar i Bordit:  
Arben Malaj

Drejtoreshë ekzekutive  
Ada Shameti

Instituti për politika publike dhe mireqeverisje

Regjistruar në Gjykatën e Tiranës  
Nr regjistrimi 389  
Rruga Ismail Qemali P.27/1  
Tirane  
Shqiperi  
www.ippm.al

## **Analizë e mëtejshme e treguesve**

Mbi bazën e të dhënave zyrtare të statistikave fiskale mujore të publikuara nga Ministria e Financave është përgatitur një analizë më e fokusuar e treguesve kryesorë të financave publike.

### ***Të ardhurat në buxhetin e shtetit***

Totali i të ardhurave për muajin Mars në vlerë nominale ishte 29.7 miliardë lekë, ose 6.19 miliardë më shumë se të ardhurat e arkëtuara gjatë të njëjtit muaj një vit më parë. Rritja prej 14.38% e të ardhurave në terma vjetore ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së të ardhurave tatimore me 11.52%. Në Mars 2014 janë arkëtuar 2.81 miliardë lekë të ardhura tatimore më shumë se në Mars 2013, nga të cilat 2.71 miliardë ka qënë rritja e të ardhurave nga tatimet dhe doganat. Në këtë rritje ka ndikuar rritja me 24.51 % e të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe rritja me 31.47% e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin, këto të fundit nominalisht me 950 milionë lekë krahasuar me Marsin 2013.

Të dhënave kumulative tregojnë se gjatë 3-mujorit 2014 janë arkëtuar 6.19 miliardë lekë ose 8.16 % më shumë se gjatë 3-mujorit të parë të 2013-s.

Sipas Indeksit të IPPM, në muajin Mars, të ardhurat e realizuara ndaj të ardhurave totale të parashikuara nga Buxheti 2014 janë 0.12 pikë përqindje më poshtë se pesha mesatare e të ardhurave të realizuara për muajin Mars gjatë 10 viteve të fundit. Ndërsa 3-mujori 2014 është 0.26 p.p. më poshtë se pesha që 3-mujori i parë zë në indeks.

### ***Shpenzimet e qeverisë qendrore***

Gjatë muajit Mars 2014, shpenzimet totale pësuan një rritje prej 9.64 % krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, duke arritur vlerën 34.14 miliardë lekë,

Shpenzimet për interesat në Mars 2014 u rritën me 9.64 % krahasuar ne Marsin 2013, ku vlen për t'u theksuar një rritje e shpenzimeve për interesat e huaja me 67.97 % ose 253 milionë lekë në terma vjetorë.

Gjatë 3-mujorit 2014, shpenzimet totale janë në nivelet e 88.41 miliardë lekë ose 2.37 % më pak se gjatë periudhës Janar-Mars 2013.



secretary@ippm.al  
www.ippm.al

Rr. Ismail Qemali, P.27/1  
Tirane, Shqiperi

Instituti per politika publike dhe mireqeverisje

Regjistruar ne Gjykatën e Tiranës  
Nr regjistrimi 389  
Rruga Ismail Qemali P.27/1  
Tirane  
Shqiperi  
www.ippm.al



Referuar Indeksit 10-vjecar të IPPM 2004-2013, vlen për t'u theksuar se pesha e shpenzimeve totale të realizuara gjatë Marsit 2014 ndaj parashikimit në Buxhetin 2014, është 0.18 pikë përqindje mbi mesataren 10 vjeçare të shpenzimeve për Marsin. Për 3-mujorin shpenzimet totale janë 0.58 p.p. nën peshën e Indeksit.

secretary@ippm.al  
www.ippm.al

Rr. Ismail Qemali, P.27/1  
Tirane, Shqiperi

### ***Investimet publike***

Investimet publike në muajin Mars 2014 arritën vlerën nominale 7.71 miliardë lekë duke shënuar një rritje prej 2.68 miliardë lekë krahasuar me muajin Mars 2013, kjo e shprehur në terma relativë, 53.52% më shumë.

Referuar statistikave kumulative për Janar-Marsin 2014 , investimet publike gjatë vitit 2014 janë 26.66 % ose 3.82 miliardë lekë më pak se investimet publike të kryera gjatë të njëjtës periudhë vitit 2013.

Sipas Indeksit të IPPM, pesha e investimeve publike të realizuara gjatë muajit Mars 2014 ndaj investimeve publike të parashikuara në Buxhetin 2014, është 4.46 pikë përqindje mbi mesataren 10 vjeçare për muajin Mars, kurse në terma kumulative 0.3 p.p. nën vlerën e Indeksit për 3-mujorin e parë.

---

*Për të marrë në kohë reale Buletinin e Financave Publike ju lutem kontaktoni me Ada Shameti, Drejtore Ekzekutive e Institutit për Politika Publike dhe Mirëqeverisje në [adashameti@ippm.al](mailto:adashameti@ippm.al) ose na shkruani në [secretary@ippm.al](mailto:secretary@ippm.al)*

Informacione të mëtejshme mbi analizën e paraqitur në Buletinin e Financave Publike mund të gjenden në:

***Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje***  
[www.ippm.al/buletiniifinancavepublike](http://www.ippm.al/buletiniifinancavepublike)

***Ministria e Financave, Statistika mujore fiskale***  
[www.minfin.gov.al](http://www.minfin.gov.al)

Instituti për politika publike dhe mireqeverisje

Regjistruar ne Gjykatën e Tiranës  
Nr regjistrimi 389  
Rruga Ismail Qemali P.27/1  
Tirane  
Shqiperi  
[www.ippm.al](http://www.ippm.al)